REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

DREJTORIA E LEGJISLACIONIT DHE SIGURISË NË OPERIM

Nr.1210/1 prot. Tiranë, më 12.5.2025

VENDIM

Nr.21, datë 12.5.2025

PËR

MIRATIMIN E "PROCEDURA PËR LICENCËN E OPERIMIT TË TRANSPORTUESIT AJROR"

Në mbështetje të pikës ë, të nenit 14, të Ligjit Nr.53/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil":

V E N D O S A

1. Miratimin e ACAA–DER–LOTAP "Procedura për Licencën e Operimit të Transportuesit Ajror", Lëshimi 02, Rishikimi 00.
2. Ngarkohet Drejtoria e Rregullimit Ekonomik për zbatimin dhe përdorimin e kësaj procedure.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE - AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL - TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL I SHQIPËRISË

PROCEDURA PËR LICENCËN E OPERIMIT TË TRANSPORTUESIT AJROR

ACAA–DER–LOTAP
Lëshimi: 02, Rishikimi 00
Data: 12.05.2025

Miratoi:
Maksim Et'hemaj

Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - TIRANË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Qëllimisht lënë bosh

0. ADMINISTRIMI

Tabela e Përmbajtjes

0.1 Regjistër i rishikimeve.....3
0.2 Lista e miratimeve.....3
0.3 Tabela e rishikimeve.....4
0.4 Lista e shpërndarjes.....4
0.5 Komentet e përdoruesve.....4
0.6 Shkurtimet dhe përkufizimet.....5
1. QËLLIMI.....8
2. BAZA LIGJORE DHE RREGULLATORE.....8
3. STRUKTURA DHE FUNKSIONET E SPO / DER.....8-9
4. INPUTET.....9
5. KOMISIONI I DHËNIES SË LICENCAVE TË OPERIMIT.....9
6. PROCESI I PUNËS PËR LËSHIMIN / REFUZIMIN E LICENCËS SË OPERIMIT.....10-12
7. PROCESI I PUNËS PËR VLEFSHMËRINË E AOL SË LËSHUAR.....13-14
8. PROCESI I PUNËS PËR PEZULLIMIN DHE REVOKIMIN E LICENCËS SË OPERIMIT.....15-16
9. REKORDET.....17
ANEKS 1 FORMAT.....17

0.1 Regjistri i rishikimeve

Tabela e mëposhtme përshkruan datat dhe arsyen e ndryshimeve të ndryshme të procedurës aktuale. Një vijë e zezë vertikale në anën e majtë të faqes identifikon ndryshimet me versionin e mëparshëm.

Nr. Leshimit	Nr. Rishikimit	Data	Rishikuar nga	Arsyet e ndryshimit
01	01	07.08.2012	SPO	Rishikimi i procedurës për licencat e operimit për transportuesit ajror sipas standardeve të përcaktuara nga njësia e kontrollit dhe ruajtjes së cilësisë. Përditësimi i procedurës në tërësi në raport me bazën ligjore në fuqi
02	00	05.05.2025	SPO	Ndryshime madhore

0.2 Lista e miratimeve

Veprimi	Emri dhe pozicioni	Data	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Znj. Kejda Koshaj, Specialist në SPO Z. Redi Alikaj, Specialist në SPO Z. Redi Buçka, Përgjegjës në SPO	5.5.25 5.5.25 5.5.25	
Pranuar nga:	Znj. Amarilda Nakuçi, Drejtor i DER	6.5.25	
Rishikuar nga:	Z. Elton Kacagjeli, Specialist në SQSC Znj, Krista Garo, Përgjegjës në SQSC Znj. Edlira Kraja, Drejtor i DLS	08.05.25 09.05.25	
Miratuar nga:	Z. Maksim Et'hemaj, Drejtor Ekzekutiv	12.5.25	

0.3 Tabela e rishikimeve

Faqe #	Numri I lëshimit.	Numri rishikimit	Data	Rishikuar nga

0.4 Lista e shpërndarjes

Kontroll #	Personi Përgjegjës	Tipi I Dokumentit
Origjinal	SPO / DER SSS/DAM	Kopje e printuar
Origjinal (Electronik)	DER Staff	Kopje elektronike tek DRMS

0.5 Komentet e Përdoruesve

I gjithë personeli i interesuar duhet të jetë i njohur me përmbajtjen e kësaj procedure, të paktën në lidhje me detyrat e tyre dhe t'u përmbahet në çdo kohë politikave, proceseve dhe procedurave të përcaktuara në të. Çdo devijim ose reagim duhet të raportohet në SPO nëpërmjet formularit ACAA-DLS-DMSP-200.

0.6 Shkurtimet dhe përkufizimet

Për qëllimin e kësaj procedure do të përdoren shkurtimet e mëposhtme me shpjegimet përkatëse:

Akronime / Shkurtimet #	Kuptimi
ZPEA	Zona e Përbashkët Evropiane e Aviacionit
AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
DE	Drejtor Ekzekutiv i AAC
ICAO	International Civil Aviation Organization
DER	Drejtoria e Rregullimit Ekonomik
DFS	Drejtoria e Standardeve të Fluturimit
SPO	Sektori I Lejeve dhe Operimeve
AOC	Certifikata e Operatorit Ajror
AOL	Licenca e Operimit të Transportuesit Ajror
SEOS	Sektori i Mbikëqyrjes Ekonomike dhe Statistikave
OA	Operator Ajror

Termi	Përkufizimi
Licencë operimi	Autorizim i dhënë nga autoriteti kompetent licencues një sipërmarrjeje, për të kryer transport ajror të pasagjerëve, të postës dhe ose të ngarkesave, duke e lejuar atë të ofrojë shërbime ajrore siç është parashikuar në licencë operimi.
Autoriteti Kompetent Licencues	Autoriteti i Aviacionit Civil që ka të drejtë të japë, refuzojë, të anulojë ose të pezullojë një licencë operimi.
Shërbim ajror	Një fluturim ose një seri fluturimesh më qëllim transportin e pasagjerëve, ngarkesës dhe/ose postës me pagesë dhe/ose me qira.
Fluturime lokale	Fluturim që nuk përfshin transportin e pasagjerëve, postës dhe /ose ngarkesës ndërmjet aeroporteve të ndryshme ose pika të tjera të autorizuara uljeje.
Komision	Komisioni i Dhënies së Licencave të Operimit është një strukturë e posaçme administrative që krijohet nga titullari i autoritetit licencues kompetent
Transportues ajror	Sipërmarrje me një licencë të vlefshme operimi ose një licencë operimi të vlefshme
Transportes ajror shqiptar	Transportues ajror i cili zotëron një licencë operimi të vlefshme të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar
Transportues ajror i huaj	Transportues ajror me një licencë të vlefshme operimi të dhënë nga një autoritet licencues kompetent i huaj
Transportues ajror i ZPEA-së	Transportues ajror me një licencë operimi të vlefshme të lëshuar nga një autoritet kompetent licencues në përputhje me parashikimet e marrëveshjes shumëpalëshe.
Sipërmarrje	Çdo person fizik ose juridik, qoftë fitimprurës apo jo, apo çdo organ tjetër zyrtar, qoftë me personalitetin e vet juridik ose jo.
Kontroll efektiv	Një marrëdhënie e përbërë nga të drejta, kontrata ose çdo mënyrë tjetër, e cila qoftë individualisht ose bashkërisht dhe, duke konsideruar faktet dhe legjislacionin jep mundësinë e ushtrimit direkt ose indirekt të një ndikimi në vendim marrje për një sipërmarrje, kryesisht nëpërmjet – së drejtës për të përdorur të gjitha ose pjesë të aseteve të një sipërmarrjeje, p te drejtave ose kontratave që kanë ndikim në vendimet për përbërjen, votimin ose vendimet e organeve të një sipërmarrjeje ose ndryshe kanë ndikim në vendimet për funksionimin e biznesit të një sipërmarrjeje
Plan Biznesi	Përshkrim i hollësishëm i veprimtarive tregtare të synuara nga transportuesi ajror për periudhën në fjalë, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e pritshëm të tregut dhe investimet që do të kryhen, duke përfshirë implikimet financiare dhe ekonomike të këtyre veprimtarive.
Pasqyrat financiare	Nënkuptojnë një paraqitje të strukturuar financiare, si dhe një paraqitje të transaksioneve që ndërmerren nga një organizatë.
Vendi kryesor i biznesit	Zyra qendrore ose zyra e regjistruar e një transportuesi ajror në Republikën e Shqipërisë, brenda të cilit ushtrohen funksionet kryesore

	financiare dhe kontrolli operues, duke përfshirë menaxhim të vazhdueshëm të gatishmërisë për punë të avionëve, të transportuesit ajror shqiptar.
Fluturimet për qëllime private	Përfshijnë operimet e një avioni me anë të të cilit një person ose sipërmarrje kryen operime jo-tregtare në trafikun ajror kombëtar ose ndërkombëtar për transport të personave dhe sendeve për përdorim vetjak.
Avionë me fuqi ultra i lehtë	Avioni ultra i lehtë, me një peshë maksimale ngritjeje më të ulët se 5700 kg, shtyrja/tërheqja e të cilit në ajër realizohet nga fuqia e një motori.

Simbolet e përdorura gjatë përshkrimit të proceseve kanë këtë kuptim:

⬭ Fillimi/Fundi i procesit/procedurës

▭ Aktivitet

◇ Pikë vlerësimi, vlerësim i një aktiviteti (me përgjigje PO ose JO)

1. Për hapin e parë dhe të fundit do të përdoret forma ovale. Ovalet do të tregojnë hapa konkret që e aktivizojnë ose përmbyllin procesin (p.sh. shprehja e interesit, lëshimi apo refuzimi i certifikatës, zgjedhja e zyrtarit, mbyllja e dosjes) e jo vetëm "Fund" pasi ky hap është i fundit dhe tregohet vizualisht me formë ovale.
2. Vija e veprimit që rikthehet në ndonjërin prej hapave paraprakë është përdorur në anën e djathtë në rastet kur ekziston vetëm një kolonë. Nëse ekzistojnë dy kolona paralelisht, ajo është përdorur edhe në anën e majtë.
3. Në hapat ku ka opsione (kutia romb apo "Pikë Vlerësimi" është shkruar pranë vijave "PO", "JO" ose diçka tjetër). Rrjedhimisht edhe teksti i kutisë do të jetë në formë pyetjeje.

1. QËLLIMI

Procedura është përpiluar në përputhje me kërkesat rregullatore të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 802, datë 28.12.2023 i cili përcakton kërkesat për dhënien e licencës së operimit për ofrimin e shërbimeve ajrore, procedura, si dhe kriteret dhe kushtet për pezullimin dhe revokimin e saj. Sektori i Lejeve dhe Operimeve në Drejtorinë e Rregullimit Ekonomik është përgjegjës për menaxhimin dhe koordinimin e të gjitha proceseve të lëshimit dhe mirëmbajtjes së kësaj licence duke bashkëpunuar ngushtësisht me Komisionin për Dhënien e Licencave të Operimit. Procedura për licencat e operimit është hartuar për të standardizuar proceset e punës në lidhje me lëshimin/refuzimin, pezullimin , revokimin e AOL duke përcaktuar qartë rolin dhe bashkëpunimin ndërmjet strukturave të brendshme dhe të jashtme të përfshira në këto procese.

2. BAZA LIGJORE DHE RREGULLATORE

1. Ligjin Nr. 96/2020 "Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë";
2. Ligjin Nr.53/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil";
3. Ligjin Nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit";
4. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.802, datë 28.12.2023, "Për miratimin e kërkesave për dhënien e licencës së operimit për ofrimin e shërbimeve ajrore, procedurat, kriteret dhe kushtet për refuzimin, pezullimin apo revokimin e licencës së operimit", i cili transpozon Rregulloren Evropiane Nr.1008/2008 të ndryshuar;
5. Udhëzimin e Përbashkët Nr.11 datë 24.12.2024 "Për tarifat që zbatohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil".
6. Marrëveshjet dypalëshe të lidhura në fushën e transportit ajror ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të tjera, kur ato kanë parashikime që lidhen në mënyrë direkte apo indirekte me licencimin.

3. STRUKTURA DHE FUNKSIONET E SPO / DER

Sektori i Lejeve dhe Operimeve (SPO) është pjesë e Drejtorisë së Rregullimit Ekonomik, sipas strukturës së AAC-së, miratuar me Urdhër Kryeministri Nr.3 datë 12/01/2023 "Për miratimin e strukturës së AAC". SPO është përgjegjës për ndjekjen e procedurave të lidhura me lëshimin, refuzimin, pezullimin apo revokimin e licencës së operimit të një transportuesi ajror të regjistruar në RSH.

Detyrat e SPO janë pjesë integrale e Rregullores së Brendshme të AAC-së, referuar nenit 25, pika 2, si dhe Aneksit 1 të rregullores për Procedurat e Rekrutimit në AAC, të miratuar me Vendimin Nr.2, datë 15.2.2023.

Figura 1. Organigrama e DER



4. INPUTET

Burimet kryesore të punës të lidhura me proceset e AOL janë:

- Shkresat zyrtare të palëve të interesuara për AOL;
- Dokumenta financiarë dhe ekonomikë të operatorit ajror;
- Prova të reputacionit të mirë;
- Certifikata e siguracionit;
- Çdo informacion tjetër i kërkuar nga strukturat e AAC në përputhje me kërkesat rregullatore;
- Dokumenta dhe suplemente mbi mbikëqyrjen ekonomike të organizmave ndërkombëtarë në fushën e aviacionit civil.

5. KOMISIONI I DHËNIES SË LICENCAVE TË OPERIMIT

Pavarësisht se të gjitha proceset e AOL ndiqen dhe koordinohen nga SPO, për rastet e lëshimit, refuzimit, pezullimit dhe revokimit të saj, ngrihet me urdhër të DE një komision ad hoc. Urdhri përmban përbërjen, kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit, si dhe mënyrën e informimit dhe raportimit tek Drejtori Ekzekutiv. SPO sugjeron në përbërje të komsionit: jurist, ekonomist dhe staf teknik meqenëse ka çështje ligjore, ekonomike e teknike për t'u shqyrtuar. Komisioni do të përbëhet nga 5 veta dhe do të përcaktohet kryetari, sekretari dhe anëtarët.

Për rastet kur AOL pezullohet apo revokohet për arsye të pezullimit apo revokimit të AOC sipas pikës 5, të Nenit 10 të VKM nr.802, datë 28.12.2023, nuk do të ngrihet Komision, por procedura do të ndiqet nga SPO në bazë të njoftimeve nga DFS për AOC. Gjykohet të mos nevojitet shqyrtim nga Komisioni duke qenë se, pezullimi apo revokimi i AOC kërkon pezullimi apo revokim të menjëhershëm të AOL, pa qënë e nevojshme të vlerësohen rrethana apo arsye shtesë.

6. PROCESI I PUNËS PËR LËSHIMIN / REFUZIMIN E LICENCËS SË OPERIMIT

1. Me marrjen e kërkesës nga sipërmarrësi, SPO[1] vlerëson nëse plotësohen kriteret:
   - *Shteti Shqiptar dhe/ose shtetas/it e tij kanë më shumë se 50% të sipërmarrjes dhe e kontrollojnë efektivisht atë.*
   - *Vendi kryesor i veprimtarisë së saj është RSH;*
   - *Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me objekt kryesor të veprimtarisë transportin ajror, ose këtë të kombinuar me çdo operim tjetër tregtar të avionëve apo transportin ajror të kombinuar me riparim dhe mirëmbajtje avionësh;*
   - *Është në proces aplikimi apo zotëron një AOC të vlefshme të lëshuar nga AAC;*
   - *Ka një ose më shumë se një avion në dispozicion përmes pronësisë ose marrëveshjes së qirasë së thatë – dry lease;*
2. Pasi konstaton që kriteret e mësipërme plotësohen, njofton DE për ngritjen e Komisionit dhe përgatit urdhrin për të.
3. Njofton Komisionin dhe përcakton datën e takimit të parë në të cilin jep informacionin e plotë në lidhje me aplikimin e sipërmarrësit duke theksuar se, afati për shqyrtimin e kërkesës dhe dhënien e miratimit apo refuzimit është **jo më shumë së 3 muaj** nga momenti që është paraqitur i gjithë dokumentacioni i nevojshëm.
4. SPO mban procesverbalin dhe njofton sipërmarrësin nëse ka nevojë për plotësim dokumentacioni.

   Dokumentacioni i plotë nevojitet të përmbajë, përveç sa listuar në pikën 1 këtu, edhe:
   - *Sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit ajror. Komisioni do të sigurojë që certifikatat e sigurimit të paraqitura nga sipërmarrja aplikuese janë të vlefshme, si dhe mbulojnë përgjegjësitë e transportuesit ajror ndaj pasagjerëve, bagazheve, kargos dhe postës, sipas vlerave të përcaktuara në rregullatorët ligjorë*
   - *Dokumentacionin e përfshirë në* Formën ACAA-DER-LOTAP 100
   - *Dokumentacion që provon reputacionin e mirë të tilla që tregojnë që nuk kanë shpallje falimenti dhe certifikatë të gjendjes gjyqësore. Kur shteti nuk i siguron këto dokumenta i kërkohet të bëjë një deklarim me betim para një organi kompetent gjyqësor ose administrativ ose një organi noterial, të cilët lëshojnë një certifikatë që vërteton vërtetësinë e deklaratës me betim ose deklaratë solemne. Kjo certifikate nevojitet të depozitohet pranë Komisionit.*
   - *Dokumentin financiar për të verifikuar që plotëson kushtet financiarë për lëshimin e AOL, sipas pikës 1 të Aneksit 1 të VKM Nr. 802, datë 28.12.2023. Gjithashtu mund t' i kërkohen* të pasqyrojë *çdo veprimtari tjetër tregtare të sipërmarrjes, qoftë kjo direkte apo indirekte, si dhe aftësitë paguese për të mbuluar shpenzimet fikse dhe operative për një periudhë prej 3 (tre) mujore nga fillimi i*

[1] SPO bashkëpunon me njësi të tjera, sipas nevojave, për të bërë këtë vlerësim paraprak

operimeve, pa marr parasysh ndonjë të ardhur nga operimet, por kjo gjithmonë në varësi të nevojës për të amortizuar vlerësimin financiar të kompanisë. Vlerësimi bëhet sipas formës Form ACAA-DER-LOTAP-100 deri tek Forma ACAA-DER-LOTAP 107;

- *Nëse sipërmarrësi do të këtë në përdorim edhe avion me qira të njomë (wet lease), nevojitet një miratim paraprak nga DFS në lidhje me sigurinë në operim të tij.*

5. Me plotësimin e dokumentacionit, Komisioni shqyrton aplikimin në tërësi. Në përfundim të çdo takimi SPO mban procesverbalet dhe ndjek të gjitha sugjerimet e lëna nga Komisioni.
6. Nëse Komisioni gjykon rëndësinë e dëgjimit të sipërmarrësit, mund t' i kërkojë SPO të njoftojë të interesuarin.
7. Gjatë këtij procesi SPO siguron që AOC të ketë dalë përpara se të lëshohet AOL.
8. Aplikohet tarifa përkatëse për AOL sipas Udhëzimit të Përbashkët Nr.11 datë 24.12.2024 për Tarifat që zbatohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil duke bashkëpunuar me njësinë e financës.
9. Vendimi final i Komisionit për refuzim apo miratim i komunikohet DE me memo nga SPO .
10. Në rast se Komisioni ka refuzuar lëshimin e AOL, sipërmarrësit i përcillen edhe arsyet e refuzimit.
11. Nëse Komisioni ka miratuar AOL, DE nxjerr një vendim, i cili publikohet edhe në faqen zyrtare të AAC-së.
12. SPO plotëson Formën e Licencës së Operimit ACAA-DER-LOTAP-109 dhe i dërgohet një kopje sipërmarrësit, një kopje ruhet në arkivë dhe një kopje në SPO/DER.
13. Në shkresën që përcjell AOL, SPO do të theksojë edhe detyrimin e OA për të njoftuar AAC për çdo planifikim për kryerjen e një shërbimi ajror të ri[2], që nuk është kryer më parë, për çdo shkrirje apo blerje të synuar, si dhe brenda 14 ditëve për çdo ndryshim në pronësi të çdo aksioni që përfaqëson 10% ose më shumë të aksioneve të përgjithshme të OA.
14. SPO përgatit shkresë informuese mbi miratimin/refuzimin e AOL edhe për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Komisionin Evropian.
15. SPO sigurohet që Vendimi për lëshimi e licencës së operimit të publikohet në faqen zyrtare të AAC-së.

Një sipërmarrës do të paraqesë përsëri kërkesën për AOL nëse: -Nuk ka bërë transport ajror për një periudhë 6 mujore nga data e lëshimit të AOL; -Ka ndërprerë operimet për më shumë se 6 muaj; -Synon të ngazhohet në operime me kapacitet avioni/ësh më të madh nga çfarë ka deklaruar kur i është lëshuar AOL e parë.

[2] SPO njoftohet sipas sezoneve të IATA për ndryshimet e shërbimeve ajrore të OA

Skema 1. PËR LËSHIMIN / REFUZIMIN E LICENCËS SË OPERIMIT



7. PROCESI I PUNËS PËR VLEFSHMËRINË E AOL SË LËSHUAR

Për të siguruar mbarëvajtjen me transportin ajror të kompanisë ajrore së cilës i është lëshuar një AOL nga AAC, si dhe të për të mundësuar transport të sigurt ajror për të gjithë pasagjerët, nevojitet të monitorohen dhe mbikëqyren:

- Situata financiare e kompanisë ajrore;
- Siguracioni i detyrueshëm (duke qenë se kompanitë zakonisht i faturojnë me afat 1 vjeçar);
- Reputacioni i mirë, nëse ka informata apo indicie mbi të;
- Kohëzgjatja e përdorimit të avionit/ëve me qira të njomë.

Ky monitorim zhvillohet si nga SPO ashtu edhe nga Sektori i Mbikëqyrjes Ekonomike dhe Statistikave (SEOS). Për këtë arsye të dy sektorët nevojiten të bashkëpunojnë duke u koordinuar procesi nga SPO.

Vlefshmëria e AOL monitorohet:
- 2 vjet pasi është dhënë një AOL;
- Çdo vit;
- Më shpejt se 1 vit apo 2 vite kur dyshohet se ka një problem;
- Me kërkesë të çdo institucioni tjetër.

- SPO kujdeset që të komunikojë me kompaninë ajrore dhe SEOS për të kryer vlerësimin e përshtatshmërisë financiare për OA që i është lëshuar AOL 2 vite më parë.
- SEOS mbikëqyr situatën financiare të kompanisë ajrore në bazë të llogarive të audituara, jo më vonë se 6 muaj pas ditës së fundit të vitit financiar përkatës. Ky proces realizohet duke u bazuar tek dokumentacioni që OA duhet të vërë në dispozicion të SEOS/DER. Lista e dokumentave është e përcaktuar në pikën 3 të Aneksit 1, të VKM Nr.802, datë 28.12.2023 " Informacioni që duhet dhënë për vlerësimin e përshtatshmërisë financiare të vazhdueshme të mbajtësve ekzistues të licencës".
- Nëse nëpërmjet vlerësimit të situatës financiare, konstatohet që cënohet siguria e operimeve të OA, atëherë SEOS njofton SPO dhe DFS. Gjithsesi, SEOS njofton SPO për çdo vlerësim financiar të kryer.
- Nëse e gjykon të arsyeshme për vlerësimin e AOL, SPO, përveç informacionit për situatën financiare, mund të kërkojë nga OA edhe dokumenta të tjerë të cilat provojnë përmbushjen e kritereve për lëshimin/mbajtjen e AOL (reputacioni, siguracioni etj).
- Kur OA raporton të ketë ndryshime në pronësi, aksione, shkrirje apo blerje të synuar për të cilat SPO dhe SEOS vlerësojnë të ketë lidhje të rëndësishme më financat e OA, i kërkohet paraqitja e një plani biznesi të rishikuar, i cili duhet të përmbajë këto ndryshime dhe duhet të mbulojë një periudhë prej 12 muajsh nga data e zbatimit të tij, si dhe informacioni që është i parashikuar në pikën 2 dhe 3 të Aneksit I, të VKM 802, datë 28.12.2023.

- Vlerësimi i parashikimit operacional dhe financiar për çdo vit kryhet bazuar në pikën 2 dhe 3 të Aneksit I, të VKM 802, Datë 28.12.2023.
- Për AOL të lëshuara për avionë më pak se 10 ton MTOM (masa maksimale e lejuar per ngritje) dhe/ose më pak se 20 vende, SPO dhe SEOS do të bashkëpunojnë për të vlerësuar që kapitali neto i OA është të paktën 100 000 euro ose nëse ka tregues të qartë të ekzistencës së problemeve financiare, të kërkohet informacioni financiar (sipas gjykimi të SEOS) për të vlerësuar situatën financiare të tranportuesit ajror. Nëse këta OA kryejnë shërbime ajrore të programuara ose xhiroja financiare kalon 3 milionë euro në vit, SPO dhe SEOS ndërmarrin hapat për të kryer vlerësim të situatës financiare sikurse për avionët me më shumë se 20 vende dhe më shumë se 10 ton MTOM.
- SEOS përgatit Raportin e Mbikëqyrjes Ekonomike mbi bazë analize krahasimore me vitet e mëparshme kur e gjykon të nevojshme dhe me mesataren e industrisë së aviacionit.
- Dorëzimi i raportit për miratim te DE dhe protokollimi i tij.
- Vënia në dispozicion i raportit mbikëqyrës për SPO dhe DFS.
- Komunikim me operatorët ajrorë në përfundim të procesit të monitorimit të vlefshmërisë së licencës së operimit.
- Kur evidentohet që ka problematikë të theksuar të OA që ndikojnë sigurinë në operim për aq sa është parashikuar në kuadrin ligjor, SPO vlerëson dhe ndjek procesin e punës për pezullimin apo revokimin e AOL sipas pikës 8 këtu më poshtë.

DFS nevojitet të njoftojë SPO/DER për çdo ndryshim në AOC, të cilat duhet të pasqyrohen në AOL, si pesha e avionit, numri i ndenjësve, lloji i transportit, pezullimi apo revokimi i AOC etj

8. PROCESI I PUNËS PËR PEZULLIMIN DHE REVOKIMIN E LICENCËS SË OPERIMIT

- Nëse SPO do të verifikojë se, transportuesi ajror ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme, atëherë ky është tregues që AOL mund të pezullohet apo revokohet:

1. Paqëndrueshmëria financiare;
2. Pezullimi apo revokimi i Certifikatës së Operatorit Ajror (AOC);
3. Mungesa e reputacionit të mirë;
4. Dhënia e informacionit të rremë AAC-së, me dashje apo nga pakujdesia, për çështje të rëndësishme.

- Kur gjykon paraprakisht se nevojitet pezullimi apo revokimi i AOL, SPO komunikon me Drejtorin e DER dhe me DE, dhe përgatit urdhrin për ngritjen e Komisionit.
- Komisioni merr në konsideratë faktin se, paqëndrueshmëria financiare përbën arsye për pezullim apo revokim kur vlerësohet se OA nuk mundet të përmbushë detyrimet e tij potenciale dhe aktuale për një periudhë 12 mujore. Komisioni vendos nëse do të lëshohet licencë e përkohshme me afat jo më shumë se 12 muaj, me kushtin që operimet të jenë të sigurta dhe OA do të riorganizohet financiarisht brenda 1 viti.
- Kur DFS njofton SPO për pezullimin apo revokimin e AOC, atëherë SPO përgatit shkresat për pezullimin apo revokimin e AOL pa qenë nevoja të mblidhet Komisioni. Është e rëndësishme të sigurohen evidenca nga DFS të pezullimeve apo revokimeve të AOC.
- Komisioni shqyrton çështjen e reputacionit në bazë të dokumentave të lidhura me falimentin, dënimet, regjistrimet në QKB etj
- Për pikën 4 këtu, Komisioni shqyrton rast pas rasti se cila konsiderohet çështje e rëndësishme për të cilën është dhënë informacion i rremë me dashje apo nga pakujdesia dhe në varësi të gjykimit merret vendimi ose jo për pezullimin apo revokimin e AOL.
- SPO mban procesverbale për të gjitha rastet/takimet e mësipërme dhe përditëson DE mbi mbarëvajtjen e tyre nëpërmjet takimeve direkte, e-maileve ose shkresave.
- SPO njofton DE për vendimmarrjen e Komisionit për pezullimin apo revokimin nëpërmjet një memoje.
- DE nxjerr Vendimin për pezullimin apo revokimin e licencës së operimit të OA.
- SPO përgatit shkresën për OA në lidhje me këtë Vendim ku nënvizon arsyet se kur Operatori nevojitet të deklarojë ndryshimet që kërkojnë rishikim të AOL.
- SPO përgatit shkresën për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Komisionin Evropian.
- SPO sigurohet të publikojë në faqen zyrtare të AAC-së, vendimin për pezullimin apo revokimin e AOL.

SPO sigurohet që të publikohet një kopje e kësaj procedure ne faqen zyrtare të AAC-së dhe të jetë gjithmonë e përditësuar në të, me ndryshimet që merr herë pas here.

Skema 2. PËR PEZULLIMIN DHE REVOKIMIN E LICENCËS SË OPERIMIT



9. REKORDET

Dokumentacioni i prodhuar arkivohet për vitet e parashikuara për kësi dokumentash në Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat", dhe Ligjin Nr. 27/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat".

Aneks 1- FORMAT

Format e mëposhtme janë bashkëlidhur kësaj procedure dhe miratimit të saj

- Forma ACAA-DER-LOTAP-100: Kërkesa për pajisjen me Licencë Operimi të Transportit Ajror
- Forma ACAA-DER-LOTAP-101: Formati i sugjeruar për planin e biznesit
- Forma ACAA-DER-LOTAP-102: Të ardhurat e parashikuara me bazë mujore për vitin e parë të aktivitetit. Buxheti ekonomik tremujor, gjashtëmujor dhe 3 vitet e para te aktivitetit.
- Forma ACAA-DER-LOTAP-103: Performancë ekonomike e parashikuar për 3 vitet e para të aktivitetit
- Forma ACAA-DER-LOTAP-104: Pasqyra e kapitalit të parashikuar për ushtrimin e aktivitetit për 3 vitet e para (Gjendja e kapitalit)
- Forma ACAA-DER-LOTAP-105: Pasqyra e flukseve të parashikuara të parasë për vitin e parë të aktivitetit, për çdo zë kryesor të arkëtimeve dhe pagesave sipas tipologjisë së shërbimit të arkëtuar/paguar.
- Forma ACAA-DER-LOTAP-106: Parashikimi mbi indikatorët operative.
- Forma ACAA-DER-LOTAP-107: Skeda e monitorimit 6-mujor.
- Forma ACAA-DER-LOTAP-108: Modeli i licencës së operimit.
- Forma ACAA-DER-LOTAP-109: Modeli i licencës së përkohshme të operimit.

Forma ACAA-DER-LOTAP-100

APLIKIMI PËR PAJISJEN ME LICENCË OPERIMI TË TRANSPORTIT AJROR

Emërtimi: Selia ligjore: Data dhe vendi i themelimit: Numri i regjistrimit të shoqërisë: Telefoni: Fax: Email: Faqe web: Aplikim për Tip A ☐ ose Aplikim për Tip B ☐ të Licencës së Operimit (Tip A avionë me 20 vende ose më shumë, Tipi B me më pak se 20 vende) Data e paraqitjes së kërkesës për lëshimin e AOL: Llojet e shërbimeve të transportit ajor që propozohen Data e parashikuar për fillimin e operimit Bazat operative:

STRUKTURA E SHOQËRISË

Përcaktoni më poshtë detaje mbi çdo person apo shoqëri që zotëron më shumë se 5% të totalit të njësive/aksioneve të emetura(lëshuara).

Emri i Anëtarit(aksionerit): Nënshtetësia: Numri i njësive/ aksioneve: Lloji i njësive/ aksioneve: % mbi totalin e lëshuar:

TË DHËNA MBI GRUPIN E MUNDSHËM TË SHOQËRIVE

Emri i shoqërisë/-ve kontrolluese (nëse ka), data dhe vendi i themelimit: Emri i shoqërisë mëmë (nëse ka), data dhe vendi i themelimit:

PËRBËRJA E SHOQËRISË E CILA KONTROLLOHET NGA SHOQËRIA MËMË

Në qoftë se aplikanti është një shoqëri që kontrollohet nga Shoqëria mëmë të përcaktohen në vijim të dhënat për çdo person apo shoqëri që zotëron më shumë se 50% të totalit të aksioneve të lëshuara nga Shoqëria kontrolluese.

Emri i Anëtarit(aksionerit): Nënshtetësia: Numri i njësive/ aksioneve: Lloji i njësive/ aksioneve: % mbi totalin e lëshuar:

ÇËSHTJE TË TJËRA QË MUND TË NDIKOJNË NË KONTROLLIN EFEKTIV TË APLIKUESIT

Informacione të tjera që s'janë dhënë më sipër dhe që lidhen me personin që zotëron pronësinë dhe kontrollin efektiv të shoqërisë.

ORGANI ADMINISTRATIV

Shënoni më poshtë emrat dhe kombësitë e anëtarëve të Bordit Drejtues të shoqërisë së aplikuesit dhe të çdo shoqërie tjetër kontrolluese të deklaruar.

Përbërja e Bordit Drejtues të aplikantit: Përbërja e Bordit Drejtues të shoqërisë kontrolluese(mëmë):

MENAXHIMI I LARTË

Shënoni më poshtë detajet mbi funksionet ekzekutive pranë shoqërisë së aplikuesit , kjo nuk i referohet administratorëve të lartpërmendur.

Emri(Emërtimi): Nënshtetësia: Detyra(funksioni):

MARRËVESHJE FINANCIARE

Përcakto të dhënat financiare ose jo, të çdo marrëveshjeje, që mund të ketë një lidhje me kontrollin e shoqërisë së aplikantit,tek një fletë e veçantë.

Çdo garanci Çdo kredi të ndryshme nga ato të ofruara nga bankat apo institucionet financiare Çdo marrëveshje operative apo tregtare që përfshin një tjetër transportues Të tjera

DEKLARIM

Data: Emri: Pozicioni që mbulon(funksioni): Nënshkruar(firmosur):

DOKUMENTACION I BASHKËLIDHUR

Çertifikatë rregjistrimi QKR	
Kopje të Aktit të Themelimit	
Kopje të Statutit dhe ndryshimeve te tij	
Ekstrakti ligjor i librit të aksionarëve(ortakëve)	
Certifikate personale, vërtetim banimi dhe vërtetim nga organet kompetente nëpërmjet të cilit verifikohet që personi nuk është i dënuar dhe nuk ka proces penal të hapur ndaj tij ose dokumenta të barazvlefshme me to.	
Forma ACAA-DER-LOTAP-100 e procedurës	
Forma ACAA-DER-LOTAP-101 e procedurës	
Forma ACAA-DER-LOTAP-102 e procedurës	
Forma ACAA-DER-LOTAP-103 e procedurës	
Forma ACAA-DER-LOTAP-104 e procedurës	
Forma ACAA-DER-LOTAP-105 e procedurës	
Forma ACAA-DER-LOTAP-106 e procedurës	

Forma ACAA-DER-LOTAP-101

FORMA PËR PLANIN E BIZNESIT

a) Përmbledhje ekzekutive
- Misioni;
- Objektivat;
- Faktorët e suksesit.

b) Përmbledhja e kompanisë
- *Pronësia e kompanisë* - duke përfshirë detajet e burimit të financimit dhe aksionarëve të propozuar, kombësinë e tyre dhe detajet e plota të aksioneve të zotëruara. Dokumentacioni i dobishëm mbështetës do të përfshinte çdo marrëveshje të aksionerëve dhe Nenet e Shoqatës;
-*Përmbledhja e fillimit* - përfshin detaje të kostove dhe se si do të financohen këto;

-*Vendndodhja* dhe objektet e zyrës qendrore.

c) Analiza SWOT
- Përparësitë;
- Dobësitë;
- Mundësitë;
- Kërcënimet.

d) Shërbimet

- Përshkrimi i shërbimeve të propozuara që do të operohen - duke përfshirë linjat dhe oraret e propozuara;
- Strategjia e çmimeve – detajet e strukturës së tarifës;
- Teknologjia e disponueshme - zhvillimi i sistemeve të menaxhimit të prodhimit ose rezervimit të brendshëm ose blerja e teknologjisë ekzistuese;
- Mënyra dhe arsyet për zgjedhjen e avionit (qiratë ose blerje). Draftet e çdo marrëveshjeje të propozuar;
- Draft-Kontratat me palët e treta - Duhet të sigurohen kopjet e çdo kontrate të propozuar.

(për mirëmbajtjen e avionëve, karburantin, normat e interesit ose marrëveshjet me blerësin tregtar për trajtimin e faturave të kreditit, etj).

e) Analiza e Tregut

- Një raport mbi mjedisin aktual të tregut të fluturimeve;
- Detajet e konkurrentëve në çdo route (rrugë) të synuar;
- Bazat e supozimeve të kërkesës të përdorura në parashikimet financiare;
- Çdo studim i pavarur i kërkimit të tregut;

f) Strategjia dhe zbatimi

- Strategjia e marketingut;
- Strategjia e çmimeve;
- Strategjia e promovimit;
- Strategjia e shitjes;

g) Përmbledhje e menaxhimit

- Struktura organizative;
-Ekipi i Menaxhmentit-përfshirë CV-të;
- Plani i personelit.

h) Vlerësimi i rrezikut të biznesit dhe atij financiar

-AAC do të duhet të sigurohet që aplikanti ka sisteme të përshtatshme për monitorimin e rreziqeve të tilla dhe politika të mjaftueshme për të zbutur ndikimet e një rreziku të tillë.

Rreziqet kryesore që duhen marrë parasysh duhet të përfshijnë sa vijon;

Rreziku i biznesit;
Risku financiar;
Konkurrenca;
Karburanti;
Humbja e pjesës së tregut;
Këmbimi valutor;
Strategjia e shpërndarjes;
Strategjia e produktit
Rentabiliteti;
Problemet në rajonet e operuara;
Bilanci i gjendjes.

i) Parashikimet financiare

Parashikimet financiare duhet të përfshijnë sa vijon;

- Parashikime të detajuara për një periudhë trevjeçare që përfshin llogarinë fitim/humbje, parashikimin e fluksit të parasë dhe bilancet me bazë mujore.
- Parashikimet duhet të detajojnë minimalisht treguesit kryesorë të performancës, si : kapacitetin, load factor, rendimentet (bruto& neto) dhe pasagjerët. Gjithashtu duhet të përfshijë informacionin mbi fluturimet e skeduluara, charterat, si dhe të ardhura ndihmëse.
- Duhet të jepen detaje të plota të parashikimit në lidhje me të ardhurat dhe kostot.
- Kur aplikanti është pjesë e një grupi, AAC do të kërkojë që informacioni i parashikimit të mësipërm të jepet mbi një bazë të konsoliduar, e cila ndan veçmas divizionet e ndryshme tregtare të grupit;
- Nëse aplikanti ka kryer më parë aktivitet tregtar, duhet të dorëzojë llogaritë e audituara më së fundi. Nëse aplikanti është pjesë e një grupi, atëherë duhet të dorëzojë llogaritë e audituara për kompaninë mëmë.

Forma ACAA-DER-LOTAP-102

TË ARDHURAT E PARASHIKUARA ME BAZË MUJORE PËR VITIN E I-rë TË AKIVITETIT

Parashikimi	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nen	Dhje	Total/mesatare
Kapaciteti i sediljeve në shitje													
Faktori i ngarkesës													
Pasagjerë													
Të ardhura totale													

BUXHETI EKONOMIK 3- MUJOR, 6-MUJOR DHE VITI I-rë I AKTIVITETIT

3 muaj 6 muaj 31.12 (viti 1)

Të ardhura nga fluturimet e skeduluara
Të ardhura nga fluturimet charter
Të ardhura të tjera ndihmëse
Të ardhurat nga aktiviteti
Shpenzime karburanti për avion
Shpenzime tarifa aeroportuale për pasagjerët
Shpenzime ground –handling
Shpenzime mirëmbajtjeje dhe revizionimi (kontrolli)
Qiramarrja dhe qiradhënia
Shpenzime tregtare dhe marketingu
Shpenzime të sigurimit
Kosto e shitjes
Fitimi Bruto
Shpenzime për personelin
Shpenzime administrative
Amortizimi i pronës dhe pajisjeve
Fitimi operacional (*EBITDA)*

Interesa mbi furnitorët financiarë
Të ardhura të tjera/shpenzime
Fitimi/humbje nga shitja e aseteve jo korente
Të tjera shpenzime financiare
Fitimi (humbja) para taksave (EBITA)
Shpenzimeve tatim fitimi aktual
Fitimi (humbja) Neto
*: Për vitin e parë të aktivitetit, 3 muaj dhe 6 muaj llogariten që nga data e parashikuar e fillimit të aktivitetit.

Forma ACAA-DER-LOTAP-103

PERFORMANCË EKONOMIKE E PARASHIKUAR PËR 3 VITET E PARA TË AKTIVITETIT

	31.12.n	31.12.n+1	31.12.n+2
Të ardhurat e trafikut			
Të ardhura të tjera			
Të ardhurat nga aktiviteti			
Shpenzime karburanti per avion			
Shpenzime tarifa aeroportuale për pasagjerët			
Shpenzime ground –handling			
Shpenzime mirëmbajtjeje dhe revizionimi (kontrolli)			
Qiramarrja dhe qiradhënia			
Shpenzime tregtare dhe marketingu			
Shpenzime të sigurimit			
Kosto e shitjes			
Fitimi Bruto			
Shpenzime për personelin			
Shpenzime administrative			
Amortizimi i pronës dhe pajisjeve			
Amortizimi i aseteve të paprekshme			
Fitimi operacional (*EBITDA)*			
Interesa mbi furnitorët financiare			
Të ardhura te tjera/shpenzime			
Fitimi/humbje nga shitja e asteve jo korente			
Të tjera shpenzime financiare			
Fitimi (humbja) para taksave (EBITA)			
Shpenzimeve tatim fitimi aktual			
Fitimi (humbja) Neto			

Forma ACAA-DER-LOTAP-104

PASQYRA E KAPITALIT E PARASHIKUAR E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT PËR 3 VITET E PARA (GJENDJA E KAPITALIT)

	31.12.n	31.12.n+1	31.12.n+2
Gjendja në fillim të periudhës			
Kapital i nënshkruar i paguar			
Kapital i nënshkruar i papaguar			
Fitimi neto për periudhën kontabël			
Balanca në fund të periudhës			
Kapital i nënshkruar i paguar			
Kapital i nënshkruar i papaguar			
Fitimi neto për periudhën kontabël			
Balanca në fund të periudhës 31.12n+1			
Kapital i nënshkruar i paguar			
Kapital i nënshkruar i papaguar			
Fitimi neto për periudhën kontabël			
Balanca në fund të periudhës 31.12.n+2			

TË PËRDORURA

	31.12.n	31.12.n+1	31.12.n+2
Kredi ndaj aksionerëve për derdhje C.S.			
Kapital i ngurtësuar			
Pasuri jomateriale			
Materiale			
Financiare			
AKTIV I NGURTËSUAR			
Teprica (pjesa e mbetur)			
Kredi			
Aktivitete financiare			
Disponibiliteti likuid			
Këste dhe diskonte aktive			
AKTIV QARKULLUES			
KAPITALI I INVESTUAR			

BURIME

	31.12.n	31.12.n+1	31.12.n+2
Kapitali i Shoqërisë			
Fondet rezervë			
Fitimet nga ushtrimi i aktivitetit			
GJENDJA E KAPITALIT NETO (CP)			
Fonde në rast rreziku dhe për detyrimet (taksat)			
TFR			
Borxhe financiare afatmesëm dhe afatgjatë			
DETYRIME TË KONSOLIDUARA (PC)			
Borxhe tregtare			
Borxhe financiare afatshkurtër			
Diskonte pasive			
DEFICIT RRJEDHËS (PB)			
BURIME TË SHFRYTËZUARA (FI)			

Forma ACAA-DER-LOTAP-105

PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASHIKUARA TË PARASE PËR VITIN E I-RË TË AKTIVITETIT, PËR ÇDO ZË KRYESOR TË ARKËTIMEVE DHE PAGESAVE SIPAS TIPOLOGJISË SË SHËRBIMIT TË ARKËTUAR/PAGUAR

Parashikimi	Jan	Shk	Mar	Pril	Maj	Qer	Kor	Gus	Shta	Tet	Nen	Dhj	Shuma/mes
Gjendja në Fillim													
Shpenzime -Shitje direkte -Shitje charter -Të tjera të ardhura (specifikoni)													
Të ardhura -Karburant -Të tjera -Eurocontrol -Taksat e uljeje -Shërbimet në tokë -Taksa të pasagjerëve -Catering -Kosto fikse të mirëmbajtjes -Kosto variabël të mirëmbajtjes -Personeli -Qiradhënia e makinave -Sigurimi i makinave													

-Qira -Marketing -Taksa -Të tjera (specifikoni													
Balanca e mbyllur													

Forma ACAA-DER-LOTAP-106

PARASHIKIM MBI INDIKATORËT OPERATIVE

Të dhëna mbi trafikun dhe punonjësit	Viti I	Viti II	Viti III
Fluturimet			
Pasagjerët			
Faktori i ngarkesës			
Numri i punonjësve në 31.12			
Numri mesatar i punonjësve			

Tipologjia AA/MM	Tipi A	Tipi B
-Numri i avionëve -BH e përdorshme -Konfigurimi mesatar AA/MM -Ekuipazhi x AA / MM -Konsumi i karburantit x BH -Kosto karburanti x BH -Shpenzimet e tjera (specifiko)		
Kostoja totale për BH		

Forma ACAA-DER-LOTAP-107

SKEDA E MONITORIMIT GJASHTËMUJOR

Shoqëria	

Periudha e shqyrtuar[1]			
Fluturimet operative			
Destinacionet (A/R)	Lloji	Pax të transportuara	Faktori i ngarkesës
Marrëveshje tregtare me operatorë të tjerë			
Transportues "operator"	Transportues MKTG	Destinacionet e interesuara	Lloji i marrëveshjes
Përbërja e flotës			
Tipologjia e makinave		Titujt e disponueshëm	
Të dhëna operative			
Orët e fluturimit me destinacion të largët			
Orët e fluturimit me destinacion të mesëm			
Personeli drejtues(ekuipazhi)			
Personeli i kabinës			
Të dhëna ekonomike			
Xhiroja			
Kosto karburanti			
Kosto personeli			
Kosto dry lease			
Kosto wet lease			
Kosto mirëmbajtjeje			
Kosto totale			
Rezultati i periudhës			
Situata e borxhit total			
Borxhe kundrejt handler-ave			
Borxhe kundrejt aksionerëve të administrimit			

Borxhe kundrejt Eurocontrol Totali i gjendjes kreditore		
Vonesa e anullime		
Totali rrugëve	nr. i vonesave	nr. i anullimeve

[1] *Si periudhë e shqyrtuar do të konsiderohet gjashtëmujori kalendarik.*

Në rast se veprimtaria nis në një semestër që ka filluar, të dhënat do të lidhen me atë pjesë kohe gjatë së cilës është kryer vetë aktiviteti.

Forma e licencës së operimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY

LICENCË OPERIMI
OPERATING LICENSE
Nr./ No. **AL - 001**

"TRANSPORTUESI AJROR" SHPK

Me Zyrë Qendrore/*Legal Address*: Adresa e plotë sipas regjistrit tregtar të transportuesit ajror

përmbush kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 96/2020 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" dhe në VKM Nr. 802, datë 28.12.2023 "Për miratimin e kërkesave për dhënien e licencës së operimit për ofrimin e shërbimeve ajrore, procedurat, kriteret dhe kushtet për refuzimin, pezullimin apo revokimin e licencës së operimit", dhe autorizohet për të kryer transport nga ajri të pasagjerëve, kargos dhe/ose postës, për qëllime fitimi ose qiraje, sipas specifikimeve bashkëlidhur.

fulfills the requirements stipulated in Law No. 96/2020 "Air Code of Republic of Albania" and DCM No. 802, date 28.12.2023 "For the approval of requests for the granting of an operating license for the provision of air services, the procedures, criteria and conditions for the refusal, suspension or revocation of the operating license" and is hereby authorized to carry by air passengers, cargo and/or mail for hire and or remuneration according to the attached specification.

Kjo Licencë nuk është e transferueshme dhe do të jetë në fuqi deri sa të pezullohet ose revokohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

This License is not transferable and shall remain in force unless suspended or revoked by the Civil Aviation Authority.

Lëshimi ***Nr.*** */ Issue No.:*
Datë/ *Date:* dita/muaji/viti

Emri dhe Firma

Name and Signature

DREJTOR EKZEKUTIV
EXECUTIVE DIRECTOR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY

SPECIFIKIMET E LICENCËS SË OPERIMIT
OPERATING LICENSE SPECIFICATIONS

Licenca e Operimit Nr. AL- 001

Operating License No AL- 001

Operatori/ *Operator:*	**"Transportuesi ajror" SHPK**
Lloji i Licencës/ *Type of License*:	MTOW ≥ 10 ton **Pasagjerë**- passengers ≥ 20
Lloji i Operimeve/ *Type of Operations:*	Transport: - **pasagjerësh**/*Passengers* - **kargo**/*Cargo* - **postë**/*Mail*
Administratori/ *Accountable Manager*:	**Emri i administratorit sipas regjistrit tregtar të subjektit**
Pezullime/ *Suspensions*:	
Lëshimi Nr. / *Issue No.* **Datë**/ Date: dita/muaji/viti	Emri dhe Firma *Name and signature*

DREJTOR EKZEKUTIV
EXECUTIVE DIRECTOR

Forma e licencës së përkohshme të operimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY

LICENCË OPERIMI E PËRKOHSHME
TEMPORARY OPERATING LICENSE
Nr./ No. **AL - 001**

"TRANSPORTUESI AJROR" SHPK

Me Zyrë Qendrore/*Legal Address*: Adresa e plotë sipas regjistrit tregtar të transportuesit ajror

Bazuar në kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 96/2020 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" dhe në VKM Nr. 802, datë 28.12.2023 "Për miratimin e kërkesave për dhënien e licencës së operimit për ofrimin e shërbimeve ajrore, procedurat, kriteret dhe kushtet për refuzimin, pezullimin apo revokimin e licencës së operimit", dhe autorizohet për të kryer transport nga ajri të pasagjerëve, kargos dhe/ose postës, për qëllime fitimi ose qiraje, sipas specifikimeve bashkëlidhur, për një periudhë deri në 12 muaj.

Based on the requirements stipulated in Law No. 96/2020 "Air Code of Republic of Albania" and DMC No. 802, date 28.12.2023 "For the approval of requests for the granting of an operating license for the provision of air services, the procedures, criteria and conditions for the refusal, suspension or revocation of the operating license" , and is hereby authorized to carry by air passengers, cargo and/or mail for hire and or remuneration according to the attached specification, for a period up to 12 months.

Kjo Licencë nuk është e transferueshme dhe do të jetë në fuqi deri sa të pezullohet ose revokohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

This License is not transferable and shall remain in force unless suspended or revoked by the Civil Aviation Authority.

Lëshimi *Nr.* / *Issue No.:*

Datë/ *Date:* dita/muaji/vit

Emri dhe Firma
Name and Signature

DREJTOR EKZEKUTIV
EXECUTIVE DIRECTOR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY

SPECIFIKIMET E LICENCËS SË PËRKOHSHME TË OPERIMIT
TEMPORARY OPERATING LICENSE SPECIFICATIONS

Licenca e Përkohshme e Operimit Nr. AL- 001

Temporary Operating License No AL- 001

Operatori/ *Operator:* **"Transportuesi ajror" SHPK**

Lloji i Licencës/ *Type of License*: MTOW ≥ 10 ton

Pasagjerë- passengers ≥ 20

Lloji i Operimeve/ *Type of Operations:* Transport:

- **pasagjerësh**/*Passengers*
- **kargo**/*Cargo*
- **postë**/*Mail*

Administratori/ *Accountable Manager*: **Emri i administratorit sipas regjistrit tregtar të subjektit**

Pezullime/ *Suspensions*:

Afati/ Deadline **Deri në 1 vit**/ Up to 1 year

Lëshimi Nr./ *Issue No.*
Datë/ Date: dita/muaji/viti

Emri dhe Firma
Name and signature

DREJTOR EKZEKUTIV
EXECUTIVE DIRECTOR